



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 206/21 prot.

Datë 01.04.2025

V E N D I M

Nr. 430/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaïd Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergji Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 01.04.2025, mori në shqyrtim çështjen me,

Objekt:

Mbi zbatimin e vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr.373, datë 17.03.2025, për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-27514-10-31-2024 me objekt “Rikonstruksion i Rrugës ”Nënë Tereza” Laknas”, me fond limit 77,878,432.50 (shtatëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetëmijë e katërqind e tridhjetë e dy pikë pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.

Ankimues:

BOE “LIQENI VII” SHPK (përfaqësues), me NUIS K01730502Ë, me adresë: Rruga Dituria, Zona Kadastrale nr.8516, Nr.pasurie 10/268, Lagjja 14, Kodi Postar 2007, Shkozë, Durrës, & “S.M.O.UNION” Shpk me NUIS J66902042Q.

Autoriteti Kontraktor:

Bashkia Kamëz, me adresë: Bulevardi “Nënë Tereza” nr.492 Kamëz Tiranë.

Subjekte të Interesuar:

Operatori ekonomik “BONUS Sh.p.k”, me NUIS K72412009E, me adresë: Tiranë, Rruga Jordan Misja, Zona Kadastrale 8330, Numri i Pasurisë 2/60-N11, Vëllimi 30, Faqe 105.

BOE “C O L O M B O Sh.p.k” (përfaqësues), me NUIS J82916489E, me adresë: Fier, Lagjja Kryengritja e Fierit, rruga Vangjel Rrushku, godina nr.67 & “BAJRAMI N” Shpk.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi dokumentacionin e çështjes dhe e diskutoi në tërësi,

Vëren:

I

Rrethanat e çështjes

I.1. Në date 17.03.2025, Komisioni i Prokurimit Publik me vendimin Nr.373/2025, ka vendosur:

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues BOE “LIQENI VII” SHPK (përfaqësues) & “S.M.O.UNION” Shpk, në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-27514-10-31-2024 me objekt “Rikonstruktion i Rrugës ”Nënë Tereza” Laknas”, me fond limit 77,878,432.50 (shtatëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind e tridhjetë e dy pikë pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
2. Autoriteti kontraktor të rivlerësojë, BOE “C O L O M B O Sh.p.k” & “BAJRAMI N” Shpk edhe OE “BONUS” SHPK, referuar konstatimeve në këtë vendim duke i skualifikuar këta ofertues.
3. Autoriteti kontraktor brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “COLOMBO” SHPK.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

I.2. Me shkresën me nr. 2706 prot., datë 20.03.2025, protokolluar me tonën nr. 206/17 prot., datë 26.03.2025, autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 373/2025, datë 17.03.2025.

II

Komisioni i Prokurimit Publik

Pasi shqyrtoi dokumentacionin e mësipërm,

Arsyeton:

II.1. Me shkresën me nr. 2706 prot., datë 20.03.2025, protokolluar me tonën nr. 206/17 prot., datë 26.03.2025, autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz, njofton se ka zbatuar vendimin e KPP-së Nr. 373/2025, datë 17.03.2025.

II.2. Nga verifikimi i raportit të auditit në sistemin e prokurimit elektronik, KPP konstaton se, autoriteti kontraktor ka kryer ri-vlerësimin e procedurës në sistemin e prokurimit elektronik dhe ka rivlerësuar BOE “C O L O M B O Sh.p.k” & “BAJRAMI N” Shpk edhe OE “BONUS” SHPK, referuar konstatimeve në këtë vendim duke i skualifikuar këta ofertues, në përputhje me vendimin e KPP-së Nr.373/2025, datë 17.03.2025.

Përsa më sipër, mbështetur në nenet 30, 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimin e Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenin 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të lejojë autoritetin kontraktor për vijimin me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit “Procedurë e hapur”, me Nr. REF-27514-10-31-2024 me objekt “Rikonstruktion i Rrugës ”Nënë Tereza” Laknas”, me fond limit 77,878,432.50 (shtatëdhjetë e shtatë milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tetë mijë e katërqind e tridhjetë e dy pikë pesëdhjetë) Lekë pa TVSH, zhvilluar në datën 18.12.2024 nga autoriteti kontraktor, Bashkia Kamëz.
2. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Kryetar
Jonaid Myzyri

